

Në bazë të nenit 13 paragrafi (1) të Ligjit për Qendrën Shtetërore të Provimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 142/08, 148/09, 41/14, 55/16, 142/16 dhe 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 59/25) dhe nenit 5 paragrafi 1 të Rregullores për mënyrën, procedurën dhe kriteret për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm të Qendrës Shtetërore të Provimeve, nr. 01-440/3 nga 28.12.2022, nr. 01-176/3 nga 1.3.2023, nr. 01-197/3 nga 15.04.2024, nr. 01-109/3 nga 11.02.2025, nr. 01-157/4 nga 25.3.2025 dhe nr. 01-121/3 nga 9.2.2026, Qendra Shtetërore e Provimeve shpall

KONKURS PUBLIK I PËRSËRITUR

për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm – vlerësues të pjesëve të testeve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm për kodimin e pyetësorëve në studimin ndërkombëtar ICCS 2027 – ICCS 2027 (International Civic and Citizenship Education Study)

I. Qendra Shtetërore e Provimeve shpall konkurs publik të përsëritur për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm – vlerësues të pjesëve të testeve në studimin ndërkombëtar ICCS 2027 – ICCS 2027 (International Civic and Citizenship Education Study) dhe për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm për kodimin e pyetësorëve në studimin ndërkombëtar ICCS 2027 – ICCS 2027 (International Civic and Citizenship Education Study), me të cilin hulumtohen njohuritë dhe të kuptuarit e nxënësve për nocionet dhe temat që lidhen me edukimin dhe arsimin qytetar, si dhe raportohet për vlerat, qëndrimet dhe sjelljet e tyre, si vijon:

a) Bashkëpunëtorë të jashtëm – vlerësues të pjesëve të testeve:

- 1) dy vlerësues për gjuhën maqedonase dhe gjuhën angleze dhe
- 2) dy vlerësues për gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze.

b) Bashkëpunëtorë të jashtëm për kodimin e pyetësorëve:

- 1) një person për kodimin e pyetësorëve në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.

II. Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) Kandidatët për bashkëpunëtorë të jashtëm – vlerësues të pjesëve të testeve:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut
- të kenë përfunduar të paktën studime akademike të ciklit të parë në fushën përkatëse (arsim qytetar sipas normativit për mësimdhënës);
- të kenë të paktën 3 (tre) vite përvojë pune në mësimdhënie.

b) Kandidatët për bashkëpunëtorë të jashtëm për kodimin e pyetësorëve:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të kenë përfunduar së paku arsim të lartë,
- të njohin gjuhën angleze dhe
- të njohin gjuhën në të cilën kodohen pyetësorët.

III. Kandidatët detyrimisht e dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kandidatët për bashkëpunëtorë të jashtëm – vlerësues të pjesëve të testeve:

- fletëparaqitje të plotësuar (formulari i aplikimit është i vendosur në faqen e internetit: www.dic.edu.mk);
- certifikatë shtetësie;

- kopje të certifikatës/diplomës për përfundimin e studimeve përkatëse akademike të ciklit të parë, të vërtetuar në noter dhe
- vërtetim për marrëdhënie të rregullt pune dhe përvojë përkatëse prej së paku 3 (tre) vitesh në mësimdhënie.

b) Kandidatët për bashkëpunëtorë të jashtëm për kodimin e pyetësorëve:

- fletëparaqitje të plotësuar (formulari i aplikimit është i vendosur në faqen e internetit: www.dic.edu.mk;
- certifikatë shtetësie;
- kopje të certifikatës/diplomës për përfundimin e arsimit të lartë, të vërtetuar në noter.

IV. Për kandidatët që i plotësojnë kushtet e lartpërmendura, Qendra Shtetërore e Provimeve do të organizojë trajnim, pas të cilit do të vijojë verifikimi i njohurive të kandidatëve.

Kandidatët që nuk kanë marrë pjesë në trajnim, nuk do të merren parasysh në procedurën e mëtejme.

V. Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm – vlerësues të pjesëve të testeve në studimin ndërkombëtar ICCS 2027 – ICCS 2027 dhe e bashkëpunëtorëve të jashtëm për kodimin e pyetësorëve në studimin ndërkombëtar ICCS 2027 – ICCS 2027, kryhet në mënyrë dhe procedurë të paraparë me Ligjin për Qendrën Shtetërore të Provimeve dhe me Rregulloren për mënyrën, procedurën dhe kriteret për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm të Qendrës Shtetërore të Provimeve.

VI. Afati i paraqitjes nga kandidatët e interesuar është pesë ditë.

VII. Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm do të realizohet më së voni në afat prej 18 (tetëmbëdhjetë) ditësh pas përfundimit të afatit të paraqitjes.

VIII. Dokumentacioni i vonuar, i paplotë dhe i pavlefshëm, nuk do të jetë lëndë shqyrtimi.

IX. Fletëparaqitja e plotësuar së bashku me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohet në Arkivin e Qendrës Shtetërore të Provimeve (nga ora 10:00 deri në 14:00) ose dërgohet me postë të rekomanduar në adresën e mëposhtme: Qendra Shtetërore e Provimeve – Shkup, rr. “Vasil Gjorgov” p.n., 1000 Shkup, me shënimin:

“Për konkurs publik për bashkëpunëtorë të jashtëm – vlerësues të pjesëve të testeve në studimin ndërkombëtar ICCS 2027” ose “Për konkurs publik për bashkëpunëtorë të jashtëm për kodimin e pyetësorëve në studimin ndërkombëtar ICCS 2027”.

X. Informacione shtesë për konkursin publik mund të merren në numrin e telefonit 075/340-924, çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në 14:00.

QENDRA SHETETËRORE E PROVIMEVE